

VENDIM
Nr. 55, datë 28.10.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Elbasan (UK Elbasan), me shkresën nr. 1764 prot., datë 30.7.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor të UK Elbasan në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria UK Elbasan ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 157 349 banorë në Bashkinë Elbasan;

b) drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Julian Doçi, zotëron diplomë master në “Inxhinieri hidroteknike”, marrë në mars të vitit 2011 dhe ka 8 vite përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Elbasan, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Elbasan, rekomandon:

- Shoqëria UK Elbasan duhet të aplikojë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, me një strukturë të re tarifore.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Elbasan është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a., me NUIS L43121201L në kategoritë:

- a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) kategoria C – për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) drejtues ligjor – z. Luan Dervishi;
- b) drejtues teknik – z. Julian Doçi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a., është:
Bashkia Elbasan.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4- vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani